



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 172/25 Dt. 10.03.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Memorandunit të Mirëkuptimit, 01 nr. 155/25 datë 27.02.2025 për financimin e projektit infrastrukturor në Komunën e Prizrenit, i nënshkruar mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejjimin e realizimit të projektit: “Rekonstruimi i rrugës Ekrem Rexha -Drini” në fshatin Lubizhdë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nr. 10041.
3. Ky projekt realizohet konform Memorandunit të Mirëkuptimit, (protok. KKPZ 01 nr. 155/25 datë 27.02.2025 dhe protok. MMPHI nr. 1146 datë 03.02.2025) për financimin e projektit infrastrukturor në Komunën e Prizrenit, i nënshkruar mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - MMPHI,
 - Arkivës së Kryetarit.

